

### **Si kamundur Pejgamberi (s) të përdor term fraksional?**

A ka predikuar pejgamberi Ibrahim (a) mndonjë sektë? Atëherë çka mund të thuhet për pejgamberin Nuh (a) dhe pejgamberin Musa (a)? Nëse termi *Shi'a* do të kishte kuptim fraksional ose sektarë, as Allahu nuk do ta përdorte si formë e piedestalit më të lartë të profetëve, as pejgamberi Muhamed (s) nuk do të lartësonte atë.

Duhet theksuar se pejgamberi (s) asnjëherë nuk ka dëshiruar që muslimanët të ndahen në grupacione. Ai urdhëroi njerëzit të ndjekin Imam Aliun (a) si përfaqësues të tijin gjatë jetës së vet dhe si trashigues dhe Kalif pas tij. Por për fat të keq ata të cilët iu nënshtruan dëshirës së pejgamberit, ishin në një numër shumë të vogël dhe njiheshin si "*Shi'at* e Aliut". Ata ishin të nënshtruar gjitha formave të diskriminimit dhe persekutimit edhe kanë vuajtur prej ditës kur Mëshira ndaj Njerëzimit, pejgamberi Muhamed (s) ndërroj jetë. Nëse gjithë muslimanët do t'i nënshtroheshin dëshirës së pejgamberit, atëherë nuk do të ekzistonte asnjë grupacionë brenda islamit. Në një rastë pejgamberi (s) ka thënë:

**"Menjëherë pas meje në mesin e juaj do të filloj urejtja dhe përçarja, kur të vij një situatë e tillë drejtohuni tek Aliu se ai mund ta ndajë të mirën nga e meta."**

□ Ali Mutteki El Hindi - *Kanz al-'Ummal* (Multan) Vol. 2 f. 612, numri 32964

Sa i përket ajetit Kur'anor të lartëpërmendur, disa dijetarë Sunnit kanë transmetuar nga Imam Xhafer el-Sadik (a), Imamit të gjashtë nga familja e pejgamberit (*Ehlulbejt*)e ka thënë:

"Ne jemi litari i Allahut për të cilin, Allahu ka thënë: *Kapuni për litarin e Allahut dhe mos u përçahuni mes veti*

□ al-Tha'labi, *Tafsir al-Kabir*, under commentary of verse 3:103

□ Ibn Hajar al-Haythami, *al-Sa'at al-Muhriqah*, (Cairo) Ch. 11, section 1, p. 233

Sipas kësaj, nëse Allahu dënon fraksionalizimin atëherë Ai dënon edhe ata të cilët ndahen nga litari i vet dhe nga ata të cilët mbahen fortë për të!

### **Përfundim:**

Ne kemi treguar se termi *Shi'a* është përdorur në Kur'an për ithtarët e shërbetorve të mëdhenj të Allahut dhe në thëniet e profetit potencuar për ithtarët e Imam Aliut (a). Ai i cili ndjek një udhëzim të tillë hyjnorë u ka shpëtuar dilemave religjioze dhe është kapur fortë për Litarin e Allahut dhe i është dhënë sihariqi për në parajsë.

**Që të informoheni më shumë rreth islamit burimor vizitoni:**

<http://al-islam.org/faq/>

*Dhe kapuni fortë për litarin e Allahut  
dhe mos u përçahuni mes veti  
(Kur'ani 3:103)*

# **Pse Shi'izmi?**

Termi *Shi'a* është përemër i përdorur nga muslimanët që ndjekin Imamët nga familja e pejgamberit (s) (*Ehlulbejt*). Ata nuk e përdorin për të krijuar fraksione ose ndarje ndërmejt muslimanëve, por për arsye se Kur'ani, pejgamberi (s) dhe muslimanët e hershëm e përdorin atë, para se të ekzistonin fjalët si *Sunni* ose *Selefi*.

## Shi'at në Kur'an

Fjala *Shi'a* nënkupton "ithtarë; anëtarë të një partie". Allahu ka përmendur në Kur'an se disa shërbetorë të devotshëm të Tij kanë qenë *shi'at* e disa shërbetorëve tjerë të Tij të devotshëm.

*Dhe metëvërtetë Ibrahim i ka qenë mes Shi'ave (ithatrëve) të vet.*  
(Kur'ani 37:83)

*Ai hyri në qytet në një kohë kur banorët e tij nuk hetuan dhe aty hasi në dy vetë të cilët riheshin. Njëri ishte nga populli (Shi'at) e tjetri nga ai armik.*  
(Kur'ani 28:15)

Pra, *shi'a* (ithtarë) është fjalë zyrtare e përdorur nga Allahu në Kur'anin e Tij për profetët e tij të dalluar dhe ithatrët e drejtë të tyre.

Nëse dikush është *shi'a* (ithtarë) i robërve më të devotshëm dhe më të drejtë atëherë nuk ka asgjë të keqe në të se bëhet *shi'a*. Nga ana tjetër, nëse dikush bëhet ithtarë i një tirani apo gabimtari, ai do të ballafaqohet me fatin e udhëheqësit të vet. Sipas Kur'anit, në Ditën e Gjykimit njerëzit do të tubohen në grupe ku çdo grup do të ketë prijësin (Imamin) e vet që do t'u paraprijë. Allahu thotë:

*Atë ditë kur të thërrasim tërë njerëzit me gjithë prijësit (Imamët) tyre*  
(Kur'ani 17:71)

Në Ditën e Gjykimit, fati i ithtarëve do të mvaret nga fati i Imamit të tyre (nëse ata kanë ndjekur ndonjë Imam). Allahu ka përmendur në Kur'an se ekzistojnë dy lloj imammësh:

*I patëm bërë prijësa që ftojnë për në zjarr, kurse në ditën e gjykimit atyre nuk do të ndihmohet. Edhe në këtë botë i kemi përcjellë me mallkim, ndërsa në botën tjetër do të hudhen në zjarr.*  
(Kur'ani 28:41-42)

Kur'ani poashtu potencon për Imamët të cilët janë përcaktuar si Udhëzues për njerëzimin:

*Dhe nga mesi i tyre ne kemi caktuar prijësa (Imam), që me urdhërin tonë kanë udhëzuar në rrugë të drejtë; kanë qenë të durueshëm, kurse ndaj argumenteve tona kanë qenë të bindur.*  
(Kur'ani 32:24)

Gjithsesi, ithtarët e vërtetë (*Shi'at*) e këtyre Imamëve do të jenë të suksesshëm në Ditën e Gjykimit.

## Shi'at në Hadithe

Në historinë islame, termi "*Shi'a*" ka qenë i përdorur special për ithtarët e Imam Aliut (a). Pra, kjo frazë nuk është e shpikur vonë kur kemi parasysh se për të parën herë e ka përdorur pejgamberi i Allahut. Siç thotë ajeti në vijim:

*Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ata janë, një mend, krijesat më të mira*  
(Kur'ani 98:7)

Pejgamberi (s) i tha Aliut: "**Kjo është për ty dhe *Shi'at* e tu.**"

Ai mëtej tha: "**Betohem në Atë që jeta ime është në duart e Tij se ky njeri (Aliu) dhe *Shi'at* e tij janë të siguruar nga llogaria e Ditës së Gjykimit.**"

- Jalal al-Din al-Suyuti, *Tafsir al-Durr al-Manthur*, (Cairo) vol. 6, p. 379
- Ibn Jarir al-Tabari, *Tafsir Jami' al-Bayan*, (Cairo) vol. 33, p. 146
- Ibn Asakir, *Ta'rikh Dimashq*, vol. 42, p. 333, p. 371
- Ibn Hajar al-Haythami, *al-Savva'iq al-Muhriqah*, (Cairo) Ch. 11, section 1, pp 246-247

Pejgamberi (s) ka thënë: **O Ali (në Ditën e Gjykimit) ti dhe *shi'at* e tu tek Allahu do të ktheheni të lumtur duke kënaqur dhe Allahun dhe pastaj do të vijnë armiqtë e tu të hidhëruar dhe kokfortë.**

- Ibn al-'Athir, *al-Nihaya fi gharib al-hadith*, (Beirut, 1399), vol. 4 p. 106
- al-Tabarani, *Mu'jam al-Kabir*, vol 1 p 319
- al-Haythami, *Majma' al-Za'ea'id*, vol. 9, number 14168

Pejgamberi (s) ka thënë: **Myzhe për ty o Ali! Metëvërtetë ti dhe ithtarët (*shi'at*) e tu do të jeni në Parajsë.**

- Ahmad Ibn Hanbal, *Fadha'il al-Sahaba*, (Beirut) vol. 2, p. 655
- Abu Nu'aym al-Isbahani, *Hilyatul Awliya*, vol. 4, p. 329
- al-Khatib al-Baghdadi, *Tarikh Baghdad*, (Beirut) vol. 12, p. 289
- al-Tabarani, *Mu'jam al-Kabir*, vol. 1, p. 319
- al-Haythami, *Majma' al-Zavva'id*, vol. 10, pp. 21-22
- Ibn 'Asakir, *Ta'rikh Dimashq*, vol. 42, pp. 331-332
- Ibn Hajar al-Haythami, *al-Savva'iq al-Muhriqah*, (Cairo) Ch. 11, section 1, p. 247

